Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/448
Datë: 26.07.2023

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 19.07.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet dhe validohet** Kolegji Universum O.P, rr. 156 Fan Noli Ferizaj, për periudhën dy (2) vjeçare, përkatësisht nga data 19.07.2023 deri 18.07.2025, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 **Teknologji digjitale, Niveli V sipas KKK,** lloji: Kualifikim i bazuar në standarde ndërkombëtare E me 120 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 3 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup mund të jetë maksimalisht 25 kandidatë.

2. Akreditimi dhe validimi i institucioni është aprovuar me kushtet si në vijim:

   - Kërkesat tjera të veçanta të kualifikimit (projekte, detyra, marrëveshje me punëdhënësit, etj.);
   - Politikat dhe procedurat për zhvillimin e stafit për vlerësim, verifikim të brendshëm dhe certifikim;
   - Politikat dhe procedurat për vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara;
   - Politikat dhe procedurat e monitorimit për mundësi të barabarta në përzgjedhjen e nxënësve/kandidatëve;
   - Procedurat për njohjen dhe transferin e kredive; dhe
   - Realizimi i vlerësimit për ambient të sigurt dhe të përshtatshëm.

   2.1. Kushtet e dhëna duhet të plotësohen brenda afatit 3 mujor, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Kolegji Universum O.P Ferizaj, për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Për një vit kalendarik, lejohen (3) tre grupe me nga 25 kandidatë, që në total bëjnë 75 (3x25=75) kandidatë për një vit. Kjo shifër reflekton kapacitetin aktual të institucionit për të pranuar dhe përkrahur kandidatët në kuadër të këtij kualifikimi.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegji Universum O.P;
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK